



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E KULTURËS DHE TRASHËGIMISË KULTURORE**Nr. 2313 prot.Lezhë, më 18 .2 2026**PROJEKT-VENDIM
“PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR DHE TURISTIK PËR
PERIUDHËN 2026 - 2028”.**

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, neni 9 pika 1.1, Neni 25, në Ligjin nr.10352 datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, në VKM Nr.121, datë 25.02.2005 VKM për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.540, datë 21.12.1992 “ Për krijimin e Këshillave Artistiko-Kulturor.

PROPOZOJ:

1. Miratimin e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik pranë Bashkisë Lezhë.
2. Mandati i Këshillit artistiko-kulturor do të jetë i parashikuar në dispozitat ligjore në fuqi.
3. Anëtarët e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik do të paguhen me një shpërblim prej 4500 (katër mijë e pesëqind) lekësh për çdo mbledhje. Por jo me shume se 6 mbledhje ne vit.
4. Burimi i financimit do të jetë buxheti i Bashkisë Lezhë i miratuar me Vendim nr.113 datë 15.12.2025 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028” nga Këshilli i Bashkisë Lezhë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

KRYETARI
Pjerin Ndreu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E KULTURËS DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

Nr. 2313/ prot.

Lezhë, më 18. 2 2026

RELACION

“PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR DHE TURISTIK PËR PERIU DHËN 2026 - 2028”.

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, neni 9 pika 1.1, Neni 25, në Ligjin nr.10352 datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, në VKM nr.540, datë 21.12.1992 “Për krijimin e Këshillave Artistiko-Kulturore” i ndryshuar në VKM Nr.121, datë 25.02.2005. Miratimi e këtij Këshilli është e nevojshme për të garantuar bashkërendimin institucional dhe përfshirjen e profesionistëve të fushës në procesin e planifikimit, vlerësimit dhe orientimit të politikave vendore në fushën e artit, kulturës dhe turizmit. Këshilli Artistiko-Kulturor dhe Turistik do të ushtrojë funksione këshillimore, duke dhënë mendime, propozime dhe rekomandime lidhur me: programet dhe veprimtaritë artistike, kulturore dhe turistike, projektet për ruajtjen, promovimin dhe zhvillimin e trashëgimisë kulturore, nxitjen e turizmit kulturor dhe artistik, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përfshirjen e komunitetit. Veprimtaria e Këshillit do të zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe politikat vendore të zhvillimit kulturor dhe turistik. Ky Këshill do të ruajë marrëdhënie varësie nga administrata e Bashkisë, e cila do të orientojë veprimtaritë e këtij Këshilli në përputhje me politikat e miratuara në këto fusha dhe me fondet në dispozicion për veprimtaritë artistiko- kulturore dhe turistike. Sa më sipër ju ftojme të miratoni këtë projekt-vendim për të hapur rrugë zhvillimit të aktiviteteve artistiko-kulturore dhe turistike në qytetin e Lezhës të cilat do të financohen buxheti i Bashkisë Lezhë i miratuar me Vendim nr.113 datë 15.12.2025 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2026 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028” nga Këshilli i Bashkisë Lezhë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

KRYETARI
Pjerin Ndreu

